

MENDIM PAKICE

1. Unë, komisionere Valbona Sanxhaktari, si anëtare e trupit gjykues, nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për shkak se subjekti i rivlerësimit, në vlerësimin tim, nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për disa çështje lidhur me pasurinë dhe të arrijë një nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë.
2. Për kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale bashkohem me mendimin e shumicës së trupit gjykues.
3. Në lidhje me pasurinë **apartament banimi me sipërfaqe 84 m², në vlerën 7,400,000 (shtatë milionë e katërqind mijë) lekë, në “Rrugën e Dibrës” Tiranë**, si burime të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) bonot e thesarit të vjehrrit, z.*** ***, në shumën 3,500,000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, të depozituara në vitin 2003 në Bankën e Shqipërisë dhe të dhuruara bashkëshortit, së bashku me interesat; (ii) hua nga familjarët e bashkëshortit në masën 27,000 (njëzet e shtatë mijë) euro (nga të cilat 5,000 euro falur/dhuruar); (iii) kursime nga paga e bashkëshortit, në shumën 400,000 (katërqind mijë) lekë; (iv) kursime nga paga të subjektit të rivlerësimit (pa u specifikuar shuma përkatëse).
4. Komisioni, pas përfundimit të hetimeve paraprake, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e një rezultati negativ paraprak. Në zbatim të detyrimeve të tij ligjore për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar lidhur me rezultatet e hetimit dhe shumica e trupit gjykues ka pranuar në përfundim të procesit të pranojë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke konkluduar në një situatë pozitive për subjektin.
5. Unë, me cilësinë e anëtarit në pakicë, ndaj një qëndrim ndryshe për sa i përket dy burimeve të financimit: (1) shuma 3,000,000 (tre milionë) lekë, me burim nga bonot e thesarit në emër të bashkëshortit të subjektit (kursime të vjehrrit z.*** ***, të kaluara në emër të bashkëshortit E.K., e të dhuruara); dhe (2) huaja në shumën 27,000 (njëzet e shtatë mijë) euro, nga një llogari bashkëmrore e bashkëshortit të subjektit me motrën e tij, për të cilat në vlerësimin tim subjekti nuk arriti të provojë me prova dhe shpjegime të tjera të kundërtën e barrës së provës.
6. Konkretisht, për sa i përket shumës 3,000,000 (tre milionë) lekë, me burim nga bonot e thesarit në emër të bashkëshortit të subjektit (kursime të vjehrrit z.*** ***, të kaluara në emër të bashkëshortit E.K., e të dhuruara) kam një qëndrim ndryshe nga shumica e trupit gjykues.
7. Në këndvështrim të kuadrit ligjor për deklarimin e pasurive, çdo subjekt ka detyrë të deklarojë duke prezantuar një fotografi të interesave të tij pasurorë dhe të të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, si dhe burimin e përdorur. Mosdeklarimi i burimit të të ardhurave nga dhurimi dhe as dhurata nga prindërit në vitin 2005 tregon një panoramë të situatës, e cila e parë në këndvështrimin e sotëm nuk krijon koherencë dhe besueshmëri.
8. Në vlerësimin tim, si dhe mbështetur edhe në praktikën e Kolegjit, për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhuruar, por edhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rastit dhe rrethanave specifike konkrete.
9. Në kuptim të këtij përcaktimi, por edhe të qëndrimeve tashmë të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit, vlerësoj se analizimi i rrethanave të faktit, në rastin konkret, duhet të fokusohet në dy aspekte.

Së pari, nëse provohet se personi tjetër i lidhur mund t'i realizonte këto të ardhura (shumën prej 3,000,000 lekësh) me burime të ligjshme dhe të plotësonte gjithashtu nevojat e tyre për jetesë. Në drejtim të provimit të faktit se të ardhurat e babait (prindërve) të bashkëshortit të subjektit kanë ekzistuar, në vlerësimin tim gjej si të vetmin dokument shkresor provues vërtetim nr. ***** prot., datë **.**.2019, të lëshuar nga "Raiffeisen Bank", lidhur me depozitat e kursimit në ish-Bankën e Kursimeve. Referuar këtij vërtetimi rezulton se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë pasur depozita kursimesh në këtë bankë, të çelura në vitet 1995 dhe 1996 me të dhënat, si vijon:

- i. depozitë kursimi nr. *** në emër të shtetasve E. K. dhe J. (G) K., çelur më **.**.1995, në shumën 220,200 (dyqind e njëzet mijë) lekë dhe mbyllur në datën **.**.1996, në shumën 1,446,011 (një milion e katërqind e dyzet e gjashtë mijë e njëmbëdhjetë) lekë;
- ii. depozitë kursimi nr. ***, në emër të J. (G) K., çelur më **.**.1996, në shumën 359,158 (treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë dhe mbyllur në datën **.**.2003, në shumën 1,967,008 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetë) lekë.

Duke marrë në konsideratë si vlerë potenciale të mundshme shumën prej **1,967,008 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetë) lekësh**, vlerësoj se shuma e mbetur për krijim e vlerës 3.000.000 (tre milionë) lekë, me burim të ardhurat nga pensionet nuk janë të mjaftueshme. Ndihma financiare e prindërve në formën e dhuratës, bazuar në të ardhura nga pensionet, të cilat mund të sigurojnë veçse një jetë modeste, janë rethana që kanë një trajtim me peshë në krijimin e bindjes së brendshme. Në këto kushte, duke analizuar situatën faktike të provuar dhe dispozitat ligjore përkatëse, çmoj se prindërit kanë qenë në pamundësi për të krijuar shumën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, me të ardhura nga pensionet e tyre.

Në vlerësimin tim nuk rezulton ndonjë gjurmë tjetër bindëse se të ardhurat kanë ekzistuar më parë dhe se ato nuk lidhen me të ardhura nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, të cilët duket se kanë pasur një ekonomi të përbashkët. Nëse shuma prej 3.000.000 (tre milionë) lekësh do të vinte si dhuratë nga prindërit e bashkëshortit, siç subjekti deklaroi në deklaratën *Vetting*, dhe do të ishin si vijim i transaksioneve bankare të deklaruara gjatë hetimit, ato duhet të gjendeshin në një formë të shprehur në deklaratën e pasurisë së viteve 2005 dhe 2006, ku në fakt rezulton ndryshe.

Në vlerësimin tim, dokumenti bashkëlidhur DPV-së vitit 2006 nuk ka ndonjë vlerë provuese pasi është i pafirmosur, nuk përkon me datën e deklarimit dhe nuk del qartë se përse i është bashkëlidhur me vonesë deklarimit, si dhe koha kur i është bashkëlidhur si dokument plotësues.

Së dyti, nëse pas një vlerësimi logjik dhe të përgjithshëm të rastit, personi tjetër i lidhur do të kishte mundësi t'ia jepte dhuratë këtë shumë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, duhet të vlerësohet edhe raporti që krijohet mes të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve të përgjithshme për jetesë të personit tjetër të lidhur për periudhën që analizohet, e cila është relativisht e gjatë pasi të ardhurat e pretenduara vlerësohet se janë të mbledhura gjithë kursimeve të jetës, për sa kohë që nuk rezulton ndonjë pretendim tjetër se ai (dhuruesi) realizonte të ardhura prej ndonjë burimi tjetër të ligjshëm, por të paverifikuar.

10. I paprovuar po ashtu mbetet fakti i pretenduar nga subjekti rivlerësimit se të ardhurat nga bonot e thesarit të bashkëshortit janë pikërisht ato të krijuara nga bono thesari të mëparshme të babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë s'ka asnjë gjurmë të dokumentuar të kohës (madje ka një deklaram të ardhura nga kursimet), si dhe për sa kohë nuk ka një hetim dhe analizë të mirëfilltë të të ardhurave/shpenzimeve dhe pasurive të krijuara nga prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

11. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhjen e kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë ndërtuese "*****" sh.p.k. dhe as kryerjen e pagesës së shumës prej 28,000 (njëzet e tetë mijë)

euro në favor të kësaj shoqërie në DPV-në e vitit 2005, po ashtu, as detyrimet financiare të mbartura në atë vit – ndaj huadhënësit dhe ndaj shoqërisë ndërtuese.

12. Në këto kushte, unë vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj sipas kërkesave të pikave 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe se nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit të Komisionit, duke rezultuar në pamundësi për të provuar burimin e ligjshëm të shumës prej 3,000,000 (tre milionë) lekësh të deklaruar të fituar nga kursime dhe të investuar fillimisht në bono thesari dhe, më tej, për blerjen e apartamentit në Tiranë.

13. Lidhur me huan e marrë në vlerën 27,000 (njëzet e shtatë mijë) euro, nga motra e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, znj. L. N.¹ për krijimin e kësaj pasurie, kam një qëndrim ndryshe nga shumica e trupit gjykues.

14. Në vlerësimin tim, subjekti nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës, po ashtu edhe Komisioni në vlerësimin e provave duhet të kishte mbajtur në konsideratë se llogaria bashkëmore duhet të trajtohej si pasuri e përbashkët, për të cilën palët duhet të provonin burimin e ligjshëm, përkatësisht si edhe në raport me veprimet e kryera.

15. Kjo huadhënie duhet të vlerësohej në raport me deklaratimet e subjektit, përkatësisht ndër vite, dhe me përputhshmërinë e tyre me shpjegimet e dhëna dhe rezultatit të hetimit, po ashtu edhe me mundësinë financiare të huadhënësve.

16. Në deklaratën *Vetting*, subjekti rivlerësimit deklaroi: *“Hua nga familjarë të bashkëshortit një pjesë e shumës së huas depozituar prej huadhënësve në ‘Raiffeisen Bank’, që në vitin 2004, shuma 27.000 euro nga të cilat 5.000 euro falur/dhuruar”*.

17. Nëse i referohemi DPV-së së vitit 2007, rezultoi se subjekti rivlerësimit ka deklaruar shumën 27,000 (njëzet e shtatë mijë) euro të marrë hua, njëkohësisht edhe si detyrim financiar. Në DPV-në e vitit 2008, subjekti rivlerësimit ka deklaruar përsëri huadhënësit dhe detyrimin e mbetur në shumën 22,000 (njëzet e dy mijë) euro. Në DPV-në e vitit 2009 subjekti rivlerësimit ka deklaruar huan dhe detyrimin e mbetur në shumën 17,000 (shtatëmbëdhjetë mijë) euro. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti rivlerësimit ka deklaruar huan dhe detyrimin e mbetur në shumën 12,500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) euro. Në DPV-në e vitit 2011 subjekti rivlerësimit ka deklaruar huan dhe detyrimin e mbetur në shumën 10,000 (dhjetë mijë) euro. Më tej, subjekti nuk deklaroi asnjë të dhënë lidhur me këtë hua në DPV-të vijuese.

18. Në vitin 2014, znj. L. N., ka lëshuar Deklaratë Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2014, e cila ka të dhëna që nuk përputhen me këtë marrëdhënie huaje dhe shlyerjen e saj, e cila në vlerësimin tim nuk mund të ketë gjithashtu ndonjë vlerë provuese lidhur me këtë hua, pasi është përpiluar nga një i afërt i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk përmban të dhëna lehtësisht të vërtetuara apo në harmoni me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në DPV, përkundrazi bie ndesh me disa prej tyre.

19. Lidhur me mospërputhjet midis deklaratimeve të ndryshme, subjekti rivlerësimit ka shpjeguar se në Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2014, znj. L. N.² deklaroi se shuma e dhënë hua është kthyer mbrapsht deri në fund të vitit 2010, ndërsa referuar përgjigjes së pyetësorit nr. 2, datë 17.10.2019, kthimi pas i shumave në fjalë shtrihet deri në vitin 2012. Në këto përgjigje, subjekti i rivlerësimit shprehet se:

“Nga shuma në tërësi e huas prej 27,000 euro, pjesa tjetër prej rreth 5,100 euro, që ka shërbyer gjatë vitit 2006 për pagimin e kësteve të tjera të apartamentit është sjellë jo në rrugë bankare. Kthimi i huas, ashtu siç edhe kam deklaruar në deklaratat periodike pranë ILDKPKI-së është bërë, si më poshtë:

¹Bazuar në pikën 14, të nenit 3 dhe në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtetasja L. N. dhe bashkëshorti i saj, plotësojnë kriteret ligjore për t'u kualifikuar si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, ndaj subjektit lind detyrimi për të provuar gjendjen pasurore dhe burimet e ligjshme të tyre për të justifikuar ligjshmërinë e shumave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit.

² Njëpërjet kësaj deklarate konfirmohet marrëdhënia financiare në fjalë edhe nga pala huadhënëse.

- në vitin 2008 kemi shlyer shumën 5,000 euro;
- në vitin 2009 kemi shlyer shumën 5,000 euro;
- në vitin 2010 kemi shlyer shumën 4,500 euro;
- në vitin 2011 kemi shlyer shumën 2,500 euro;
- në vitin 2012 kemi shlyer pagesën 5,000 euro.

Shuma e mbetur prej 5,000 euro nuk na është kërkuar më nga motra e bashkëshortit dhe është dhuruar si shenjë respekti dhe mirënjohje për kujdesin e treguar nga ana jonë për prindërit, por edhe si një kompensim apo kontribut paraprak i saj për çdo eventualitet shpenzimesh, si dhe për kujdesjeje në funksion të prindërve. Shlyerja e huas së marrë është bërë cash, jo në rrugë bankare”.

20. Lidhur me mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit të kthimit të huas së mbetur dhe faljes së shumës prej 5,000 (pesë mijë) euro, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti shprehet se arsyeja e mosdeklarimit të pakësimit të mbetur dhe faljes së pjesës prej 5,000 euro është një harresë e saj, duke e konsideruar të përfunduar detyrimin monetar ndaj të tretëve.

21. Po ashtu nuk më duken bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me llogarinë e përbashkët bashkëmërore të bashkëshortit të saj me të motrën, pasi gjatë gjithë shpjegimeve pretendohet se llogaria ka qenë e motrës dhe se z. E. K. ka qenë vetëm në pozicionin e atij që kryente llogari për motrën e tij.

22. Nga hetimi ka rezultuar se llogaria ka qenë bashkëmërore dhe se kalimi i shumës prej 21,911,37 (njëzet e një mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë e tridhjetë e shtatë cent) euro nga kjo llogari tek ajo e shoqërisë ndërtuese është kryer nga z. E. K., ndërsa shuma e dytë prej 5,100 (pesë mijë e njëqind) euro është deklaruar si e marrë *cash* nga e motra në prill të vitit 2006.

23. Referuar *statement*-it të lëshuar nga “Raiffeisen Bank” arkëtimi i parë në shumën 11.000 (njëmbëdhjetë mijë) euro në datën 10.10.2003 është bërë nga motra e bashkëshortit, znj. L. N., kohë në të cilën kishte ardhur në Shqipëri. Arkëtimi i shumës së mbetur prej 10,911,37 (dhjetë mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë e tridhjetë e shtatë cent) euro është bërë nga bashkëshorti i subjektit disa muaj para kalimit të kësaj shume në llogarinë e shoqërisë ndërtuese.

24. Në shpjegimet e saj (në seancën dëgjimore) subjekti ka shpjeguar se motra e bashkëshortit kishte ardhur në Shqipëri (në muajin shtator) dhe lekët e saj ia la të vëllait, i cili i derdhi në bankë. Nga hetimi i llogarisë bankare rezulton se më tej, në datën 9.11.2005, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka bërë edhe transferimin e tyre në llogari të shoqërisë së ndërtimit. Shumën tjetër prej 5,100 (pesë mijë e njëqind) euro e ka paguar *cash* përsëri me burim të ardhura nga motra e tij (kjo e padokumentuar në ndonjë mënyrë).

25. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005 (lidhur me shumën prej 21,911,37 euro) dhe në DPV-në e vitit 2006 (lidhur me shumën prej 5,100 euro), marrëdhënien e huamarrjes me personin tjetër të lidhur, znj. L. N., dhe as detyrimin e mbartur ndaj të tretëve në këto vite, për kthimin pas të huas në fjalë.

26. Nëse i referohemi: (1) mandatpagesës së kështit të parë të blerjes së apartamentit datë 9.11.2005, me përshkrimin “likuidim i kështit të parë të shtëpisë” në masën 21,911,37 (njëzet e një mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë e tridhjetë e shtatë cent) euro, nga llogaria e përbashkët e shtetasve L. N. dhe E. K.³; dhe (2) deklarimit të subjektit të rivlerësimit në DPV rezulton se deklaroi për herë të parë në DPV-në e vitit 2007 se ka marrë një hua në masën 27,000 (njëzet e shtatë mijë) euro nga shtetasja L. N.⁴, me burim nga kursimet e përfituara nga punësimi dhe familja e saj e origjinës në Shqipëri, ashtu edhe nga emigrimi në shtetin grek nuk gjejmë asnjë rrethanë faktike të përputhur me deklaratimet e subjektit ndër vite.

³Në vitin 2014 shtetasja E. K. kryen tërheqje të depozitës gjëndje në këtë llogari prej 645 euro.

⁴ Kjo hua është deklaruar për herë të parë në nëntor të vitit 2007 në një dokument të panënshkruar nga deklaruesi, pa numër protokollit dhe pa vulën e ILDKPKI-së, me titull “s qarime plotësuese” për DIPP-në e vitit 2006.

27. Mosdeklarimi i burimit të të ardhurave nga huaja dhe as burimi i tyre tregon një panoramë të situatës, e cila e parë në këndvështrimin e sotëm nuk krijon koherencë dhe besueshmëri.

28. Në analizë të këtyre fakteve duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar qartësisht marrëdhënien e huas dhe shlyerjen e saj. Vetëm fakti i provuar i transferimit të shumës prej 21,911,37 (njëzet e një mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë e tridhjetë e shtatë cent) euro, nga llogaria bashkëmore në llogari të shoqërisë së ndërtimit, në bindjen time nuk është i mjaftueshëm për të provuar se burimi i atyre të ardhurave kanë qenë të ardhurat e krijuara nga motra e bashkëshortit të subjektit. Në vlerësimin tim kjo marrëdhënie nuk gjendet e pasqyruar në kohë në DPV dhe se të gjitha veprimet e mëvonshme të krijojnë përshtypjen e një përpjekjeje për të justifikuar burimin e këtyre të ardhurave.

29. Po ashtu edhe nëse do të analizonim mundësitë financiare të motrës së bashkëshortit rezulton se shtetasi P. N. (bashkëshorti i L. N.), për periudhën 1998 – 2005, ka realizuar të ardhura totale në masën 40,218,75 (dyzet mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë e shtatëdhjetë e pesë cent) euro⁵. Ndërkohë që, duke huazuar shumën prej 27,000 (njëzet e shtatë mijë) euro, familjes së vëllait të bashkëshortes së tij, për këto tetë vite u kanë mbetur vetëm 13,218,75 (trembëdhjetë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë e shtatëdhjetë e pesë cent) euro për përballimin e shpenzimeve jetike (në Greqi) për të njëjtën periudhë – të cilat Komisioni i vlerëson të pamjaftueshme, duke ftuar subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm mundësinë konkrete të përballimit të kostove jetike për familjen huadhënëse, në periudhën 1998 – 2005. Kur vlerësojmë mundësinë e huadhënësit duhet të vlerësohet edhe raporti që krijohet mes të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve të përgjithshme për jetesë të personit tjetër të lidhur për periudhën që analizohet, por edhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rastit dhe rrethanave specifike konkrete.

30. Në kuptim të këtij përcaktimi, por edhe të qëndrimeve tashmë të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit, vlerësoj se subjekti nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës. Deklarimet e subjektit (të padokumentura me ndonjë provë) se z. P. N. të gjitha të ardhurat e tij i ka kaluar në një llogari bashkëmore të bashkëshortes së tij dhe vëllait të saj, të cilat më pas janë përdorur tërësisht për blerjen e një apartamenti nga vëllai i bashkëshortes, nuk duken bindëse dhe nuk rezultojnë të përputhura me deklaratimet periodike të kohës. Z. P. N. së bashku me familjen kishte shkuar në emigrim për një jetë më të mire dhe në vlerësimin tim nuk duket bindëse që ai të gjitha të ardhurat e krijuara i ka dhënë hua pa interes dhe pjesërisht falur familjes së vëllait të bashkëshortes. Ky arsyetim bëhet edhe më bindës kur nuk gjen pasqyrim realist në deklaratimet periodike vjetore dhe ato të kryera më vonë krijojnë paqartësi dhe mospërputhje me situatën faktike.

31. Në vlerësimin tim, Komisioni duhet të kishte pranuar vetëm shumën 11,000 (njëmbëdhjetë mijë) euro, përsëri me rezervën e konstatuar në deklaratimet e subjektit dhe se ata nuk kanë bërë asnjë arsyetim bindës lidhur me shumën tjetër prej 16,000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) euro, e cila në vlerësimin tim mbetet e paprovuar.

32. Në përfundim, në vlerësimin tim, subjekti nuk ka mundur të provojë me dokumentacion ligjor marrëdhënien e huas mes bashkëshortit të saj dhe motrës për dhënien hua të shumës prej 27,000 (njëzet e shtatë mijë) euro në vitin 2005 dhe se marrëdhënia e huas mes tyre nuk ka qenë e deklaruar si e tillë në DPV-në e vitit 2005. Nisur nga marrëdhënia e posaçme mes palëve, në vlerësimin tim, mungesa e një dokumenti provues për dhënien e huas nuk merr një vlerë të posaçme, por mungesa e deklaratimit të kësaj tabloje nga subjekti i rivlerësimit në DPV, si dhe veprimet e mëpasme të analizuar më sipër, mjaftojnë për të krijuar bindjen se deklaratimet e subjektit janë të pamjaftueshme në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

⁵ Të ardhurat nga punësimi rezultojnë në vlerën 27,278,87 euro (periudha 2002-2005) + 3,467,035 dhrahmi (periudha 1998-2001). Ndërkohë sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 26.11.2003, rezulton se shtetasi P. N. është subvencionuar për shkak të papunësisë për 210 ditë, në vitin 2003, në vlerën 2,765,16 euro.

33. Në përfundim, unë, anëtari në pakicë krijova bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar të kundërtën e barrës së provës dhe rezultateve të hetimit të dërguara nga Komisioni lidhur me shumën 3.000.000 (tre milionë) lekë si dhuratë nga prindërit dhe shumën 27,000 (njëzet e shtatë mijë) euro si hua nga kunata, duke rezultuar kështu me pamjaftueshmëri financiare dhe burime të ligjshme për krijimin e pasurisë **apartament banimi me sip. 84 m², në Tiranë**, referuar germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

34. Referuar edhe praktikave të njohura tanimë nga Kolegji, vlerësoj se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete dhe rrethanave specifike të tyre.

Bazuar në analizën e mësipërme, arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Nasufi, nuk ka mundur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe se ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj sipas kërkesave të pikave 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe se nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës duke mos arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë dhe, për pasojë, ndaj saj duhet të ishte zbatuar masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, mbështetur në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Valbona SANXHAKTARI

Anëtare në pakicë